
QAINT
Quality, Accountability, Integrity and Transparency in Higher Education

ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim

PRISHTINË, PRILL 2022

# RAPORT I MONITORIMIT TË KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË NË AGJENCI TË KOSOVËS PËR AKREDITIM 3



# RAPORT I MONITORIMIT TË KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË NË AGJENCI TË KOSOVËS PËR AKREDITIM 3

PRISHTINË, PRILL 2022

**Publikues:**
ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
www.orca-ks.org
info@orca-ks.org
Henrik Bariç, Nr. 6
Prishtina, 10000, Kosova

**Autore:**
Liridona Ademaj

**Dizajn dhe Layout:**
Envinion

Prishtinë, prill 2022



“Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë. Falna durimin të thellojmë një punë përpara se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një ndjenë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu! Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e shtypit. Ashtu qoftë!”

[Faik Konica]

# PËRMBAJTJA


SHKURTESA DHE DEFINIME ..... 7

HYRJE ..... 8

VENDIMET E KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË (KSHC) ..... 9

INSTITUCIONET ME DHE PA AKREDITIM INSTITUCIONAL ..... 11

PROGRAMET STUDIMORE TË AKREDITUARA
NË INSTITUCIONE TË ARSIMIT TË LARTË ..... 13

NUMRI I PROGRAMEVE STUDIMORE TË AKREDITUARA NË IAL ..... 15

KOMISIONI I ANKESAVE ..... 18

SFIDAT E AGJENCISË SË KOSOVËS PËR AKREDITIM DHE KËSHILLIT
SHTETËROR TË CILËSISË ..... 19

REKOMANDIME ..... 26

ÇKA ËSHTË AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM
DHE KËSHILLI SHTETËROR I CILËSISË? ..... 28

LEGJISLACIONI ..... 29

PROCESI I AKREDITIMIT/RIAKREDITIMIT
DHE TËRHEQJES SË AKREDITIMIT ..... 31

# SHKURTESA DHE DEFINIME

- **AKA –** Agjencia e Kosovës për Akreditim, është agjenci e pavarur dhe misioni i saj kryesor është vlerësimi dhe akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit
- **KShC –** Këshilli Shtetëror i Cilësisë, është organ politikbërës dhe vendimmarrës i AKA-së, i cili përbëhet nga nëntë anëtarë, tre prej të cilëve duhet të jenë ndërkombëtarë
- **IAL –** Institucion i Arsimit të Lartë
- **Akreditim –** Njohje formale se një institucion i arsimit të lartë dhe programet e tij i plotësojnë standardet ndërkombëtarisht të pranuara të cilësisë, përmes të cilit përcaktohet statusi zyrtar i institucionit të arsimit të lartë dhe programeve të tij të studimit për një periudhë kohore
- **ENQA –** Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë
- **EQAR -** Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë
- **Bartës –** Çdo institucion i themeluar ose organ tjetër i autorizuar për ofrimin e shërbimeve arsimore në nivelin e arsimit të lartë
- **Bartës publik –** Bartës i themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës
- **Program –** Program studimi që shpie në një kualifikim ose diplomë, që jepet nga një bartës i arsimit të lartë
- **Komision i Ankesave –** Organi i cili trajton dhe shqyrton ankesat e parashtruara ndaj vendimeve të KShC-së, i cili përbëhet nga tre anëtarë të përhershëm dhe dy anëtarë rezervë
- **MAShTI –** Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

# HYRJE

Agjencia e Kosovës për Akreditim dhe Këshilli Shtetëror i Cilësisë po vazhdojnë përpjekjet për rikthimin e tyre në Asociacionin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR).

Gjatë vitit 2021, këto dy trupa kanë ndërmarrë veprime dhe vendime të ndryshme që i kontribuojnë cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit, të cilat drejtpërdrejtë afektojnë të gjithë hisedarët dhe gjendjen e arsimit në vendin tonë në përgjithësi.

Ky raport është rezultat i monitorimit të punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC), në Agjencinë e Kosovës për Akreditim gjatë vitit 2021. ORCA ka qenë e pranishme në mbledhjet e mbajtura nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë, përmes të cilave është informuar për të gjitha vështirësitë me të cilat ata janë përballur gjatë punës së tyre.

Procesi i akreditimit të të gjitha institucioneve dhe programeve të arsimit të lartë publik dhe privat, është zhvilluar përmes platformave online meqenëse kishte vështirësi në sjelljen e ekspertëve ndërkombëtarë në Kosovë, si pasojë e shpërndarjes së pandemisë dhe rrezikut për infektim.

Funksionimi me efikasitet më të lartë në proceset e vendimmarrjes për akreditimin e institucioneve dhe programeve, mund të arrihet vetëm përmes sigurimit të pavarësisë së plotë të këtij institucioni përmes hyrjes në fuqi të Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim.

Në këtë mënyrë do të pamundësohet ndikimi jo i drejtpërdrejtë i politikave të ministrave të arsimit në detyrë apo zyrtarëve të tjerë të lartë publik siç ka ndodhur viteve paraprake.

# VENDIMET E KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË (KSHC)

Në proces të akreditimit institucional gjatë vitit 2021, kanë qenë gjithsej 11 Institucione të Arsimit të Lartë (IAL), ku prej tyre 9 ishin private dhe 2 ishin publike.

Në këtë proces, katër kolegje private kanë dështuar në akreditimin institucional. Bëhet fjalë për Cacttus Education, Kolegji Globus, Kolegji UBT dega në Gjilan dhe Kolegji Universi. Ndërkaq për krahasim, në vitin 2020 me akreditim institucional ishin 9 IAL publike dhe 12 IAL private, ndërsa pa akreditim institucional gjatë atij viti, ishin 10 IAL private.

Numri i programeve studimore me akreditim gjatë vitit 2021 në Institucione të Arsimit të Lartë  publik është 227, ndërsa në IAL private është 171. Për krahasim, numri i programeve studimore me akreditim gjatë vitit 2020 në IAL publike ishte 233, ndërsa në IAL private ishte 128.

Gjatë vitit 2021, janë dhënë gjithsej 31 vendime negative për akreditim të programeve në Institucione të Arsimit të Lartë (IAL) publik dhe privat. 16 prej tyre janë dhënë për programe të IAL-ve publike dhe 15 të tjera për programe të IAL-ve private.

Për krahasim, gjatë vitit 2020 ishin dhënë 12 vendime negative nga KShC për akreditim të programeve dhe institucioneve, ku prej tyre 8 vendime ishin për akreditim institucional të Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) privat, si dhe 4 vendime ishin për programe të disa prej Institucioneve të Arsimit të Lartë privat.

Në atë periudhë kohore, KShC i kishte dhënë akreditim institucional gjithsej katër Institucioneve të Arsimit të Lartë, 1 private dhe 3 publike. Ndërkohë që nuk i kishte dhënë akreditim institucional katër IAL-ve të tjera private.

Mes tyre ishin Kolegji FAMA, Kolegji Iliria dhe Kolegji Tempulli, të cilat si Institucione të Arsimit të Lartë privat, patën dështuar për herë të dytë në procesin e akreditimit institucional.

Sipas Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës[1], Neni 14 'Licencimi i bartësve të arsimit të lartë', në pikën 4 dhe 6 thuhet se parakusht kryesor për licencim të bartësve të arsimit të lartë është akreditimi nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) dhe se bartësi konsiderohet i licencuar përveç nëse ai dështon në plotësimin e standardeve të AKA-së për akreditimin institucional.

Ndërkohë që sipas Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës[2], në Nenin 18 'Vendimi për akreditim', pika 11 thuhet se nëse institucioni i arsimit të lartë dështon të riakreditohet për herën e dytë, AKA do të njoftojë MAShT për të proceduar tutje me tërheqjen e licencës së institucionit.

1 Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, shtator 2011, linku: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761

2 Udhëzimi Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, tetor 2018, linku: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17952

## INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË




**Me akreditim:**



**Pa akreditim:**

- Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
- Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”
- Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka”
- Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”
- Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj
- Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”
- Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”
- Akademia e Kosovës për Siguri Publike
- Fakulteti i Studimeve Islame

## INSTITUCIONET PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË

|  **Me akreditim:** |  **Pa akreditim:** |
|---|---|
| Kolegji AAB | Kolegji Fama |
| AUK | Kolegji Globus |
| Kolegji Biznesi | Kolegji Iliria |
| Kolegji Dardania | Kolegji Juridica |
| Kolegji ESLG | Kosovo Art Academy |
| Akademia Evolucion | Kolegji Dukagjini |
| International Business College Mitrovica (IBC-M) | Kolegji Universi |
| Kolegji ISPE | Kolegji Arbëri |
| Kolegji Heimerer | |
| Kolegji “Pjetër Budi” | |
| Kolegji Rezonanca | |
| Kolegji Riinvest | |
| Tempulli Academy (Kolegji Tempulli) | |
| Kolegji UBT | |
| Kolegji Universum | |

# PROGRAMET STUDIMORE TË AKREDITUARA NË INSTITUCIONE TË ARSIMIT TË LARTË

## PROGRAMET STUDIMORE ME AKREDITIM NË IAL PUBLIKE SIPAS NIVELIT TË STUDIMEVE[3] JANË SI MË POSHTË;

Këshilli Shtetëror i Cilësisë ka akreditуar gjithsej 120 programe të nivelit Bachelor, 48 të nivelit Bachelor i Arteve, 64 të nivelit Bachelor i shkencës, 3 prej të cilave janë të nivelit Bachelor i Arteve (Profesional), 3 të nivelit Bachelor i Juridikut, 2 të nivelit Bachelor i Muzikës. Ndërkohë ky këshill, ka akreditуar edhe 3 programe mjekësore, 1 program të nivelit doktor i Mjekësisë Veterinare (Integruar), 1 të nivelit doktor i mjekësisë dentare (Integruar) dhe 1 të nivelit doktor i mjekësisë (Integruar).

Ndërsa në nivelin Master, KShC ka akreditуar gjithsej 92 programe studimore, 27 të nivelit Master i Arteve, 52 të nivelit Master i shkencës, 1 të nivelit Master i Arteve (Profesional), 9 të nivelit Master i Juridikut, 2 të nivelit Master i Muzikës dhe 1 të nivelit Master i Shëndetësisë Publike (Integruar).

Në nivelin e doktoratës KShC ka akreditуar 7 programe, ndërsa në nivelin doktor i shkencës janë akreditуar 2 programe. Nëse e krahasojmë me raportin e vitit të kaluar[4], këtë herë janë akreditуar 47 programe më shumë në 9 Institucione të Arsimit të Lartë publik se sa në 15 prej IAL-ve private.

Gjatë vitit 2020, në IAL publike kanë qenë të akreditуara gjithsej 121 programe të nivelit Bachelor, 91 të nivelit Master, 14 të doktoratës dhe 5 në nivelin doktor i shkencës. Pra gjatë vitit 2021, nuk ka pasur ndryshime të mëdha në numrin e programeve të akreditуara në nivelin Bachelor apo në nivelin Master.

3 Lista me programe të akreditуara nga IAL publike dhe private, 2021/22, linku: https://akreditimi.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/10/Programet-e-Akreditуara-2021-2022.pdf
4 Raporti i Monitorimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, shkurt 2021, linku: http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2021/02/Raporti-Monitorimit-te-Keshillit-Shteteror-2.pdf

## PROGRAMET STUDIMORE ME AKREDITIM NË IAL PRIVATE SIPAS NIVELIT TË STUDIMEVE[5] JANË SI MË POSHTË;

Këshilli Shtetëror i Cilësisë ka akredituar gjithsej 113 programe të nivelit Bachelor, 48 të nivelit Bachelor i Arteve, 49 të nivelit Bachelor i shkencës, 7 të nivelit Bachelor i Arteve (Profesional), 5 të nivelit Bachelor profesional dhe 7 të nivelit Bachelor i Juridikut. Ndërkohë ky këshill, ka akredituar edhe 3 programe mjekësore, 2 programe të nivelit doktor i mjekësisë dentare dhe 1 të nivelit doktor i mjekësisë dentare (Integruar).

Ndërsa në nivelin Master, KShC ka akredituar gjithsej 58 programe studimore, 24 të nivelit Master i Arteve, 25 të nivelit Master i shkencës, 1 të nivelit Master i Arteve (Profesional), 7 të nivelit Master i Juridikut dhe 1 të nivelit Master i Shëndetësisë Publike.

Numri i programeve të akredituara për vitin 2021, është rritur për 47 programe në IAL private. Për krahasim, në vitin 2020 numri i programeve në nivelin Bachelor ishte 87, ndërsa në nivelin Master kishte 40 programe të akredituara.

5 Lista me programe të akredituara nga IAL publike dhe private, 2021/22, linku: https://akreditimi.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/10/Programet-e-Akredituara-2021-2022.pdf

## NUMRI I PROGRAMEVE STUDIMORE TË AKREDITUARA NË IAL

| Lloji i diplomës | Publik | Privat | Total |
|---|---|---|---|
| Bachelor i Arteve | 48 | 48 | 96 |
| Bachelor i Shkencës | 64 | 49 | 113 |
| Bachelor i Arteve (Profesional) | 3 | 7 | 10 |
| Bachelor Profesional | 0 | 5 | 5 |
| Bachelor i Juridikut | 3 | 7 | 10 |
| Bachelor i Muzikës | 2 | 0 | 2 |
| Doktor i Mjekësisë (integruar) | 1 | 0 | 1 |
| Doktor i Mjekësisë Dentare (integruar) | 1 | 1 | 2 |
| Doktor i Mjekësisë Dentare | 0 | 2 | 2 |
| Doktor i Mjekësisë Veterinare (integruar) | 1 | 0 | 1 |
| Master i Arteve | 27 | 24 | 51 |
| Master i Shkencës | 52 | 25 | 77 |
| Master i Arteve (Profesional) | 1 | 1 | 2 |
| Master Profesional | 0 | 0 | 0 |
| Master i Juridikut | 9 | 7 | 16 |
| Master i Muzikës | 2 | 0 | 2 |
| Master i Shëndetësisë Publike | 0 | 1 | 1 |
| Master i Shëndetësisë Publike (integruar) | 1 | 0 | 1 |
| Doktoratë | 7 | 0 | 7 |
| Doktor i Shkencës | 2 | 0 | 2 |
| **TOTAL** | **224** | **177** | **401** |

## VLERËSIMI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË NGA AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM

Ekspertët ndërkombëtar e kanë kryer vlerësimin për akreditimin institucional të 11 Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL), ku nëntë prej tyre ishin private dhe dy publike.

Mes këtyre institucioneve të arsimit të lartë, shtatë prej tyre janë akreditуar dhe katër të tjera nuk janë akreditуar:

| IAL-të publike: | IAL-të private: |
|---|---|
| Universiteti i Gjakovës<br>*Është akreditуar për tri vite* | Kolegji Biznesi – Dega në Prishtinë –<br>*Është akreditуar për tri vite* |
| Universiteti i Gjilanit<br>*Është akreditуar për tri vite* | Kolegji Biznesi – Dega në Prizren –<br>*Është akreditуar për tri vite* |
| | Cacttus Education –<br>*Nuk është akreditуar* |
| | Kolegji Globus –<br>*Nuk është akreditуar* |
| | Kolegji Pjetër Budi –<br>*Është akreditуar për tri vite* |
| | Akademia Tempulli (Kolegji Tempulli) –<br>*Është akreditуar për tri vite* |
| | Kolegji UBT - Dega në Gjilan –<br>*Nuk është akreditуar* |
| | Kolegji UBT - Dega në Pejë –<br>*Është akreditуar për tri vite* |
| | Kolegji Universi –<br>*Nuk është akreditуar* |

Për shkak të rrethanave të krijuara nga emergjenca shëndetësore e pandemisë së njohur si COVID – 19, Këshilli Shtetëror i Cilësisë kishte marrë vendim që AKA të zbatojë procesin e akreditimit në distancë. Këtë e kishte lejuar Ministria e Arsimit përmes vendimit nr. Ref: 35/01B.

Procesi i vlerësimit është zhvilluar pjesërisht online, pasi që në çdo vizitë në institucionet e arsimit të lartë kanë qenë të pranishëm fizikisht të paktën dy përfaqësues të agjencisë. Në procesin e vlerësimit të institucioneve kanë qenë të angazhuar 81 ekspertë të cilët i kanë realizuar gjithsej 85 vizita në IAL të ndryshme.

Në vizitat në IAL, përfaqësues të agjencisë dhe ekipi i ekspertëve kanë zhvilluar takime me menaxhmentin e institucionit, me zyrtarë për sigurim të cilësisë, me kryesues të programeve studimore si dhe me staf mësimdhënës. Po ashtu, takim ka pasur edhe me studentë, të diplomuar dhe me disa punëdhënës të të diplomuarve. Pas këtyre takimeve, ka pasur një takim të brendshëm me vetëm ekipin e ekspertëve dhe AKA-në. Vizita ka përfunduar me një takim përmbyllës me menaxhmentin e institucionit.

Pasi që ekspertët nuk kanë qenë fizikisht në objektet e IAL-ve, identifikimi i hapësirave dhe pajisjeve është bërë përmes video materialeve të përgatitura nga IAL-të. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë i kanë marrë në shqyrtim të gjitha materialet, përfshirë edhe raportet e vetëvlerësimit, kanë kërkuar dokumentet shtesë dhe më pas kanë dorëzuar draft raportin. Pas adresimit të komenteve në raport, ekspertët në fund kanë dorëzuar raportin përfundimtar.

## RAPORTI I KOMISIONIT EVROPIAN PËR KOSOVËN

Në tetor të vitit 2021, ishte publikuar Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën[6], në të cilin ishte trajtuar edhe progresi i Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

Në këtë raport thuhej se Agjencia e Kosovës për Akreditim është duke vazhduar me përpjekjet për të rifituar anëtarësinë në Asociacionin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe në Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR).

Ishte evidentuar se kapacitetet e agjencisë ishin rritur me katër zyrtarë në vitin 2020 dhe se si gjatë vitit 2021 ishin hapur edhe tetë pozita të lira. Tutje ishte thënë se agjencia ka arritur të përfundojë ciklin e plotë të akreditimit për vitin akademik 2021-2022, duke e ulur numrin e programeve dhe institucioneve bazuar në kriteret e cilësisë.

Më pas ishte thënë se janë emëruar anëtarë të rinj në bordin e AKA-së, të cilët ishin përzgjedhur përmes procedurave transparente.

6 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, tetor 2021, fq. 93, linku: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2021-10/Kosovo%202021%20report.PDF

# KOMISIONI I ANKESAVE

## MOSFUNKSIONIMI I KOMISIONIT TË ANKESAVE

Në nëntor të vitit 2021, kryetari i Komisionit për Ankesa në Agjencinë e Kosovës për Akreditim kishte dhënë dorëheqje nga kjo pozitë për arsye personale, prandaj që nga ajo kohë ky komision është jashtë funksionit të tij.

Meqenëse edhe në korrik të vitit që lamë pas, fillimisht kishte dhënë dorëheqje një anëtare e këtij komisioni për shkak të emërimit në një pozitë publike, ky komision kishte mbetur me vetëm një anëtar tjetër të  përhershëm dhe një rezervë.

Ky komision ishte themeluar në shtator të vitit 2020, Agjencia për Akreditim kishte emëruar pesë anëtarë në këtë Komision të Ankesave[7].

Tre anëtarë ishin të përhershëm dhe dy anëtarë ishin rezervë apo alternativë. Anëtarët e përhershëm ishin Faton Merovci, Krenare Sogojeva Dërmaku dhe Muhamet Qerimi, ndërkohë që anëtarët rezervë ishin Bujar Pira dhe Haki Demolli.

7 Lajm/Themelohet Komisioni i Ankesave i Agjencisë së Akreditimit, shtator 2020, linku: https://kallxo.com/lajm/dokument-themelohet-komisioni-i-ankesave-i-agjencise-se-akreditimit/

# SFIDAT E AGJENCISË SË KOSOVËS PËR AKREDITIM DHE KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË

## DORËHEQJET E ANËTARËVE NDËRKOMBËTARË TË KSHC-SË

Në shkurt të vitit 2021, tre anëtarët ndërkombëtarë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Jeff Butel, Herb Amato dhe Magdalena Ziolo kishin dhënë dorëheqje nga pozitat e tyre në të cilat ishin emëruar në vitin 2018. Shkaktar i këtij veprimi, ishte kërkesa e Agjencisë Kundër Korrupsion për zbatimin e Ligjit për deklarimin e pasurisë[8], i cili obligon që të gjithë zyrtarët publik ta deklarojnë pasurinë e tyre.

Tutje në qershor të po atij viti, Kuvendi i Kosovës kishte emëruar shtatë anëtarët e rinj vendor dhe ndërkombëtarë, Hasnija Ilazi, Krenare Pireva-Nuçi, Seb Bytyçi, Gëzim Tosuni, Alison Felce, Cassie Barnhardt dhe Werner Stueber me mandat pesëvjeçar[9].

Mirëpo ende pa u mbushur një muaj që nga emërimi i tyre, anëtarët ndërkombëtar prezantuan dorëheqjet e tyre pas kërkesës për deklarim të pasurisë. Sipas tyre, problemi dhe arsyeja kryesore nuk ishte vetëm deklarimi i pasurisë por publikimi i atyre informatave[10].

Në tetor të vitit 2021, Kuvendi i Kosovës kishte emëruar Klemen Miklaviç si anëtarë ndërkombëtarë në Këshillin Shtetëror të Cilësisë dhe ky bord i ishte kthyer funksionalizimit.[11]

8 Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, shtator 2011, linku: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2767

9 Lajm/ Mes polemikash Kuvendi i Kosovës emëron anëtarët e rinj të KSHC-së, qershor 2021, linku: https://kallxo.com/lajm/mes-polemikash-kuvendi-i-kosoves-emeron-anetaret-e-rinj-te-kshc-se/

10 Lajm/ Avazi i vjetër i dorëheqjeve të anëtarëve ndërkombëtarë të KSHC-së, korrik 2021, linku: https://kallxo.com/lajm/avazi-i-vjeter-i-doreheqjeve-te-anetareve-nderkombetare-te-kshc-se/

11 Lajm/ Emërohet anëtari ndërkombëtar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë, 19 tetor 2021, linku: https://kallxo.com/lajm/emerohet-anetari-nderkombetar-i-keshillit-shteteror-te-cilesise/

## PRESIONI NGA KRYETARI I KOMISIONIT PARLAMENTAR PËR ARSIM

Në raportimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë para Komisionit parlamentar për Arsim, ishte diskutuar gjatë rreth vendimit për standardet e reja të akreditimit. Kryetari i Komisionit parlamentar për Arsim, kishte insistuar disa herë që të mësojë emrin e anëtarit të këtij këshilli që kishte propozuar që të bëhet plotësimi i standardeve për akreditim, duke theksuar se ai vendim kishte peshë juridike dhe se sipas tij, nuk kishte bazë të mjaftueshme ligjore për këtë gjë[12]. Ai gjithashtu kishte kërkuar nga drejtori i Agjencisë për Akreditim që t'ia përcjellë procesverbalin e mbledhjes së KSHC-së në të cilën ishte vendosur për këto kritere shtesë.

Në ndërkohë, Konferenca e Rektorëve kishte kërkuar nga ky këshill që ta shtyjë aplikimin e këtyre standardeve për një vit, në mënyrë që të bëjnë sistemimet e nevojshme brenda institucioneve të tyre[13].

Këshilli Shtetëror i Cilësisë tutje kishte vendosur që kriteret e reja për akreditim të aplikohen vetëm për programe të reja dhe jo për ato që janë në proces të riakreditimit. Në këtë mënyrë u kishin dhënë kohë të gjitha institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, që të bëjnë rialokimin e stafit akademik brenda institucionit nëpër programe studimore.

Ndërkohë që programet që ishin në proces të riakreditimit do t'i nënshtroheshin kritereve të reja të standardeve duke filluar nga viti 2022.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në shtator të vitit 2021 vendosi që të plotësoi Manualin për Akreditim duke shtuar mes tjerash dy pika rreth kritereve për hulumtim shkencor dhe titujt akademik për bartësit e programeve në nivelin Baçelor dhe Master[14].

Sipas këtij vendimi, nga 1 tetori i vitit 2021, përveç kritereve të përcaktuara me UA për Akreditim, bartësit e programeve që hyjnë në proces të akreditimit në nivelin BA/BSc duhet të kenë të paktën një punim shkencor të indeksuar nga fusha e studimit/programit, ndërsa në nivelin MA/MSc duhet të kenë të paktën dy punime nga fusha e studimit/programit në revista shkencore të indeksuara si autor i parë apo korrespondent në plat-

12 Lajm/ KSHC raporton në komisionin për arsim: S'ka akreditim pa publikime shkencore, 21 shtator 2021, linku: https://kallxo.com/lajm/kshc-raporton-ne-komisionin-per-arsim-ska-akreditim-pa-publikime-shkencore/
13 Lajm/ Konferenca e rektorëve kërkon që të shtyhen afatet e kritereve shtesë për akreditim të programeve,
14 Vendim për plotësimin e Parimeve themelore të Manualit për Akreditim, shtator 2021, linku: https://akreditimi.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/10/3236-21-Vendim-i-Plotesuar-i-KSHC.pdf

formën WEB OF SCIENCE apo SCOPUS, duke përjashtuar revistat ose shtëpitë botuese të dyshimta.

Ndërsa nga 1 tetori i vitit 2022, përveç kritereve të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për Akreditim, bartësit e programeve që hyjnë në proces të akreditimit, riakreditimit ose validimit në nivelin BA/BSc duhet të kenë të paktën thirrjen akademike Profesor Asistent dhe të paktën një punim shkencor të indeksuar nga fusha e studimit/programit. Ndërsa në nivelin MA/MSc duhet të kenë të paktën thirrjen akademike Profesor Asistent dhe dy punime në revista shkencore të indeksuara nga fusha e studimit/programit, si autor i parë apo korrespondent në WEB OF SCIENCE apo SCOPUS duke përjashtuar revistat ose shtëpitë botuese të dyshimta.

## TRANSFERIMI I STUDENTËVE MES PROGRAMEVE TËRËSISHT TË NDRYSHME

Drejtori i Agjencisë së Kosovës për Akreditim, pati denoncuar transferimet e jashtëligjshme të studentëve nëpër programe studimore përmes një letre dërguar ish-kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti[15].

Bazuar në atë letër, institucionet e arsimit të lartë privat apo kolegjet po i transferonin studentët nga një program në tjetrin pavarësisht faktit që programet nuk ishin të përafërta dhe kishin dallime thelbësore dhe rrënjësore mes vete, e kjo po ndodhte si pasojë e kufizimit të numrit të kuotës së regjistrimit të studentëve në programe të ndryshme.

Ai kishte treguar shembullin se si një student i regjistruar në programin Dizajn Grafik në nivelin Bachelor, kishte ndjekur ligjëratat në programin Infermieri në nivelin Bachelor dhe se në vitin e dytë të studimeve, ishte bërë transferimi i studentit nga programi Dizajn Grafik për në programin Infermieri, pavarësisht se programet nuk kishin ndonjë ngjashmëri mes vete.

Sipas tij, kjo ishte bërë e mundshme përmes ndihmës së Departamentit për Arsim të Lartë në Ministri të Arsimit.

15 Lajm/ Drejtori i Agjencisë së Akreditimit denoncon transferet e paligjshme të studentëve në programe, janar 2021, linku: https://kallxo.com/lajm/drejtori-i-agjencise-se-akreditimit-denocon-transferet-e-paligjshme-te-studenteve-ne-programe/

## LIGJI PËR AGJENCINË E KOSOVËS PËR AKREDITIM

Njëra ndër 13 rekomandimet e Asociacionit Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) ishte edhe krijimi i një ligji i cili rregullon punën dhe funksionimin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim por që në të njëjtën kohë edhe e siguron pavarësinë e saj dhe zbatimin e standardeve evropiane të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.

Në dhjetor të vitit 2021, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, i cili e rregullon statusin e Agjencisë si agjenci rregullatore në proceset dhe përgjegjësitë e akreditimit, riakreditimit, validimit dhe monitorimit.

Ky projektligj është duke kaluar në fazat e nevojshme shqyrtuese para hyrjes në fuqi.

## PADITË E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË NDAJ AGJENCISË SË KOSOVËS PËR AKREDITIM

Gjatë vitit 2021, Agjencia e Kosovës për Akreditim ka pranuar gjithsej 12 padi nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë publik e privat, të cilat janë iniciuar gjatë viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Në këto padi, të gjitha rastet janë fituar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.

## MUNGESA E DATABAZËS PËR NEVOJAT E TREGUT TË PUNËS

Me ndihmën e donatorëve, Agjencia e Kosovës për Akreditim gjatë vitit 2021 publikoi analizën tematike "Përgatitja e të diplomuarve kosovarë për tregun e punës – Perspektiva e punëdhënësit dhe e të diplomuarve"[16], përmes të cilës ishte synuar që të ketë një kuptueshmëri më të mirë të nevojave dhe pritshmërive të punëdhënësve dhe aftësive të të diplomuarve kosovarë nga institucionet e arsimit të lartë publik e privat.

16 Thematic Analysis Preeparation of the Kosovar Graduates for the Labor market – Employer and Alumni Perspective", linku: https://drive.google.com/file/d/11KykenlcT5y0ljmvQjyEbP26xGQYPbuP/view

Mirëpo nuk ka ende ndonjë databazë nga ana e Ministrisë së Arsimit[17], Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve[18], Agjencisë së Kosovës për Akreditim[19], Agjencisë së Statistikave të Kosovës[20] dhe Agjencisë së Punësimit[21], e cila analizon dhe shpërfaq nevojat e tregut të punës në Kosovë.

Ky lloj i informatave do të mund të publikohej në faqen zyrtare të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, përmes të cilës të interesuarit për studime universitare, do të informoheshin dhe orientoheshin për programet të cilat i nevojiten tregut të punës. Si dhe do të shërbente si udhërrëfyes për Këshillin Shtetëror të Cilësisë, gjatë procesit të marrjes së vendimit për akreditimin e programeve studimore.

## MUNGESA E SHKËMBIMIT TË INFORMATAVE PËR STAFIN AKADEMIK NË NIVEL RAJONAL

Është e nevojshme një databazë e atillë, e cila do të shërbente për informimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik dhe Privat, brenda dhe jashtë vendit, për përbërjen e stafit akademik në institucionet e akredituara, në mënyrë që t'u pamundësohet profesorëve që të angazhohen si staf i rregullt, në më shumë se një institucion të arsimit të lartë në shtete të ndryshme.

## MUNGESA E STAFIT NË AGJENCI

Agjencia aktualisht ka të punësuar tetë zyrtarë me përjashtim të drejtorit, mirëpo sipas AKA-së, janë të nevojshëm edhe tetë zyrtarë të tjerë. Në këtë agjenci nuk ka një zyrtar ligjor si dhe ka mungesë të zyrtarëve për monitorim, akreditim dhe vlerësim.

17 Faqja zyrtare e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Republikën e Kosovës, linku: https://masht.rks-gov.net/
18 Faqja zyrtare e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në Republikën e Kosovës, linku: https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,1
19 Faqja zyrtare e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, linku: http://www.akreditimi-ks.org/new/index.php/sq/
20 Faqja zyrtare e Agjencisë së Statistikave të Republikës së Kosovës, linku: https://ask.rks-gov.net/
21 Faqja zyrtare e Agjencisë së Punësimit në Republikën e Kosovës, linku: https://aprk.rks-gov.net/

Sipas *Ligjit mbi ndarjet buxhetore për vitin 2021*[22], Agjencisë së Kosovës për Akreditim, i është ndarë buxheti për 32 pozita, ngjashëm me buxhetin e vitit 2020. Andaj pritet që gjatë vitit 2022, numri i të punësuarve të rritet për 18 zyrtarë të rinj.[23]

Vështirësitë administrative në proces të rekrutimit, kriteret, cilësia e shqyrtimit të lëndëve, e shumë të tjera, kanë bërë që AKA të mos mund ta kompletojë stafin e nevojshëm, e për pasojë ende nuk kanë arritur të bëjnë monitorimin e IAL-ve.

Si pasojë e mungesës së stafit, AKA deri më tani ka shqyrtuar kriteret minimale për akreditimin e programeve studimore dhe akreditimin institucional. Pra kryesisht bëhet rishikimi i numrit profesor-studentë, sasia e pajisjeve, si dhe hapësira e objektit të IAL-ve.

Ndërkohë që kompetencë e AKA-së është edhe shqyrtimi i kërkimit shkencor të institucioneve, i politikave për zhvillimin e stafit akademik, i organizimit të brendshëm dhe qasjes së IAL-ve ndaj sigurimit të cilësisë, i monitorimit të progresit të studentëve e shumë të tjera.

## MUNGESA E MONITORIMIT TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË

Njëra ndër rekomandimet e Asociacionit Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) ishte miratimi dhe funksionalizimi i Metodologjisë së Monitorimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë në Kosovë.

Metodologjia e monitorimit plotëson Standardin 2.3 të Udhëzuesve Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG), i cili kërkon që agjencitë e sigurimit të cilësisë të përmbyllin ciklin e akreditimit me procedura pasakrediuese të cilat kanë për qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë.

Monitorimi është proces formal që duhet kryer nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), përmes të cilit verifikohet nëse institucionet e arsimit të lartë po e vazhdojnë

22 Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, linku: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=36153

23 Përmbledhje e aktiviteteve kryesore të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) gjatë vitit 2021, linku: https://akreditimi.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/02/22.01.2022-Conference-Annual-Report-Description-ALB.pdf

plotësimin e rekomandimeve të ekspertëve të jashtëm dhe po i mirëmbajnë kushtet me të cilat janë akredituar.

Kjo komponentë e Agjencisë së Kosovës për Akreditim nuk ka qenë aktive as gjatë vitit 2021 dhe mungesa e monitorimit të mirëfilltë nga AKA-ja ndaj institucioneve të cilave i ka dhënë akreditim, ka qenë evidente ndër vite.

Përmes projektit QAINT të financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), Agjencia e Kosovës për Akreditim kishte pranuar draftin fillestar të Metodologjisë së Monitorimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë në Kosovë, i cili nuk kishte arritur të aprovohej nga bordi i kaluar.

Mirëpo pas emërimit të anëtarëve të ri të bordit dhe drejtorit të Agjencisë, ky dokument është aprovuar në shkurt të vitit 2022.

# REKOMANDIME

Agjencia e Kosovës për Akreditim e ka të domosdoshme rekrutimin e stafit të nevojshëm për proceset administrative të cilat kryhen nga kjo e fundit.

Monitorimi i institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, është njëra ndër komponentat e kësaj agjencie e cila ende nuk ka arritur të zbatohet, e që mungesa e saj ka lënë hapësirë për mashtrimin e studentëve nga shumë prej institucioneve të arsimit të lartë që operojnë në vendin tonë.

Prandaj është më se e rëndësishme që agjencia të bëj përgatitjet e nevojshme dhe të fillojë sa më shpejtë me monitorimin e këtyre institucioneve, në mënyrë që të bëj parandalimin e lajthitjes së studentëve dhe që të fillojë me marrjen e masave ndaj atyre institucioneve të arsimit të lartë që i tejkalojnë apo thyejnë kushtet përmes të cilave kanë marrë akreditimin institucional dhe për programe.

Më pas është e rëndësisë së veçantë hyrja në fuqi e Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, në mënyrë që procesi i akreditimit të pavarësohet nga ndikimet e tërthorta të ministrave të ndryshëm të arsimit përmes udhëzimeve administrative, siç ka qenë praktikë e qeverisjeve të mëparshme.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë është kompletuar me anëtarët e nevojshëm përmes të cilëve të gjitha vendimet konsiderohen legjitime pavarësisht sfidave me të cilat janë përballur nga dorëheqjet e anëtarëve ndërkombëtar[24], mirëpo kjo trupë duhet përqendruar në krijimin e politikave të mëtutjeshme, në mënyrë që arsimi i lartë në Republikën e Kosovës të jetë i bazuar në nevojat e tregut të punës dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë që të diplomuarit të përgatiten me aftësitë e nevojshme për punë.

Kjo agjenci, pritet që në të ardhmen e afërt të pranojnë vendimin pas vlerësimit për ri-anëtarësim apo jo në Rrjetin Evropian të Asociacionit për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe në Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR).

24 Shënim: Tre anëtarët ndërkombëtarë Alison Felce, Cassie Barnhardt dhe Werner Stueber dhanë dorëheqje nga pozitat e tyre në KShC, si pasojë e kërkesës së Agjencisë Kundër Korrupsion për deklarimin e pasurisë së tyre. Për arsyen e njëjtë kishin dhënë dorëheqje edhe anëtarët paraprak ndërkombëtar Jeff Butel, Herb Amato dhe Magdalena Ziolo.

E për të arritur rianëtarësimin në këto dy institucione të rëndësishme për Agjencinë e Kosovës për Akreditim dhe arsimin e lartë në përgjithësi, duhet vazhduar përpjekjet për përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe për parandalimin e çfarëdo presioni apo ndikimi të jashtëm e politik që padyshim do ta dëmtojë këtë proces.

Është shumë i rëndësishëm edhe bashkëpunimi i kësaj agjencie me institucionet relevante, për të bërë hulumtimin e tregut të punës, në mënyrë që Këshilli Shtetëror i Cilësisë të bazohet në atë studim kur trajton apo shqyrton aplikimet për akreditim të programeve studimore nga institucionet e arsimit të lartë në vendin tonë.

# ÇKA ËSHTË AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM DHE KËSHILLI SHTETËROR I CILËSISË?

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) është agjenci e pavarur dhe misioni i saj kryesor është vlerësimi dhe akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit.

Ajo është përgjegjëse për procesin e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, përcakton standardet dhe harton procedurat e saj për sigurimin e cilësisë në përputhje me legjislacionin vendor dhe standardet ndërkombëtare për cilësi në arsimin e lartë.

AKA përbëhet nga bordi i saj, i njohur si Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), i cili është organ politikbërës dhe vendimmarrës, si dhe strukturë e përhershme administrative e agjencisë.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë përbëhet nga shtatë anëtarë, Hasnije Ilazi, Dukagjin Zeka, Rozafa Koliqi, Krenare Pireva-Nuçi, Gëzim Tosuni, Seb Bytyçi, si dhe një anëtarë ndërkombëtarë, Klemen Miklaviç. Anëtarët e këtij këshilli miratohen nga Kuvendi i Kosovës dhe kanë mandat 3 deri në 5 vjeçar.

KShC merr vendim për akreditim me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të vet, por asnjë vendim i KShC-së për akreditim/riakreditim nuk mund të merret pa pjesëmarrjen e të paktën një anëtari ndërkombëtar.

# LEGJISLACIONI

Në dhjetor të vitit 2021, Qeveria e Kosovës kishte propozuar Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim[25] të cilin e kishte shpërndarë tek deputetët, si dhe e kishte publikuar në ueb faqen zyrtare të Kuvendit për të vazhduar me procedurat e nevojshme. Ky projektligj ka kaluar shqyrtimin e parë në mbledhje plenare të Kuvendit dhe është duke vazhduar në fazat e tjera të parapara.

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), vepron duke u bazuar në *Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës*[26], konkretisht me Nenin 7 *'Agjencia e Kosovës për Akreditim'*, në të cilin sqarohet se AKA është agjenci e pavarur përgjegjëse për vlerësimin dhe promovimin e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë, andaj edhe siguron që standardet dhe cilësia e arsimit të lartë të plotësojë kërkesat dhe pritjet e Rrjetit Evropian të Asociacionit për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA).

AKA është përgjegjëse për inspektimin e bartësve të arsimit të lartë dhe këshillimin me Ministrinë e Arsimit lidhur me dhënien, ndryshimin ose anulimin e licencave, kryerjen e kontrolleve periodike mbi cilësinë e bartësve të licencuar të arsimit të lartë dhe marrjen e vendimit për akreditimin apo riakreditimin e tyre, vlerësimin periodik të cilësisë së programeve të ofruara nga bartësit e akredituar, si dhe shpalljen e politikave, kritereve dhe standardeve për akreditim.

*Udhëzimi Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës*[27], përcakton kompetencat e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, kërkesat dhe procedurat për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit.

AKA funksionon edhe me *Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC)*[28], përmes të cilës përcaktohet funksionimi, përbërja, mënyra e marrjes së vendimeve, detyrat

25 Projektligji për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, dhjetor 2021, linku: https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaw=348#info-div
26 Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, shtator 2011, linku: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761
27 Udhëzimi Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, shtator 2018, linku: https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/10/ilovepdf-merged.pdf
28 Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC), qershor 2018, linku: https://drive.google.com/file/d/0B7etG3bh-SBVVkt4T2J5bmZuOTdYVFN4bFZmMnFwakx3Z0tR/view

dhe mënyra e punës së këtij këshilli. Në Nenin 7 të kësaj rregulloreje, 'Përgjegjësitë dhe funksionet e KShC-së', thuhet se KShC përcakton objektivat kryesore dhe afatet kohore të procesit të vlerësimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL), miraton Standardet, Procedurat dhe Kriteret e vlerësimit të jashtëm të IAL-ve të hartuara nga AKA.

Ky këshill, gjithashtu harton dhe miraton statutin e AKA-së, rregulloret dhe dokumentet tjera të nevojshme për funksionimin e Agjencisë.

Në *'Rregulloren mbi punën e Komisionit të Ankesave'*[29], përcaktohen rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të ankesave, si dhe rregullohet puna, organizimi dhe kompetencat e Komisionit të Ankesave. Neni 4 i kësaj rregullore, *'E drejta e ankesës'*, sqaron se palët mund të paraqesin ankesë nëse vendimi është marrë si rezultat i shkeljes së dispozitave lidhur me procedurën e marrjes së vendimit të KShC-së, në rast të zbatimit të gabuar të ligjit material apo rregullave materiale të zbatueshme dhe nëse vendimi nuk bazohet në faktet dhe provat e prezantuara.

Në *Udhëzimin Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e UA për akreditimin e institucioneve të Arsimit të lartë*[30], në Nenin 2, është shtuar paragrafi ku thuhet se IAL-ve të cilave u është refuzuar apo tërhequr akreditimi institucional apo i programeve të studimit, mund të aplikojnë përsëri brenda periudhës prej 90 ditëve nga pranimi i vendimit përfundimtar. Gjithashtu i është lejuar AKA-së, që të verifikojë të dhënat e paraqitura nga IAL-ët në çdo kohë, pa qenë nevoja që IAL-ët të jenë në proces vlerësimi për akreditim ose riakreditim.

Ndërkohë që edhe në *Udhëzimin administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e UA për plotësimin dhe ndryshimin e UA për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë*[31], ishte shtuar se stafi akademik i cili është i deklaruar brenda institucionit sipas afateve ligjore edhe ata të cilët nuk janë deklaruar në asnjë IAL, kanë të drejtën e riaplikimit në afat prej 90 ditësh pas marrjes së vendimit përfundimtar refuzues.

29 Rregulloren mbi punën e Komisionit të Ankesave, 2019, linku: http://akreditimi-ks.org/docs/LawRegulation/Rregullorja_e_komisionit_te_ankesave.pdf

30 Udhëzim Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e UA për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, gusht 2019, linku: https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/05/ua-masht-08-2019-per-ndryshim-dhe-plotesim-te-ua-nr-15-18.pdf

31 Udhëzim administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e UA për plotësimin dhe ndryshimin e UA për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, korrik 2019, linku: https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/07/4dd5f6a7-x.pdf

# PROCESI I AKREDITIMIT/ RIAKREDITIMIT DHE TËRHEQJES SË AKREDITIMIT

Akreditimi mund të bëhet në nivelin e institucionit të arsimit të lartë, programit të studimit, degës dhe programeve të studimit të cilat ofrohen në atë degë dhe njohjes së akreditimit valid ndërkombëtar. Kërkesën për akreditim mund ta bëj vet institucioni i arsimit të lartë, për nivelin e institucionit dhe programeve të tij të studimit, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MAShTI) dhe Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) në raste specifike.

Akreditimit fillestar i nënshtrohet secili institucion, i cili pretendon të ofrojë arsim të lartë në Kosovë, ndërkohë që riakreditimit, i nënshtrohen institucionet e akredituara të arsimit të lartë në baza periodike.

Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL), i cili aplikon për akreditim/riakreditim, duhet të dorëzojë kërkesën për akreditim bashkë me listat e stafit akademik, për të cilat KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program studimi.

Nëse vlerësimi preliminar nga KShC është pozitiv, nënkuptohet se aplikacioni i plotëson kushtet formale sipas akteve juridike në fuqi duke autorizuar drejtorin e AKA-së, për zhvillim të procedurave për procesin e vlerësimit dhe akreditimit. Ndërkaq nëse vlerësimi preliminar është negativ dhe KShC konstaton se aplikacioni ka mangësi dhe nuk i plotëson kushtet formale, atëherë KShC merr vendim për refuzim të aplikacionit.

Pas aprovimit të listës së stafit akademik dhe aplikacionit, AKA pranon një raport të vetëvlerësimit nga institucioni përkatës, të cilin pastaj do t'ia përcjellë ekipit të vlerësuesve të jashtëm ndërkombëtarë. Ky ekip shkruan një raport të jashtëm të vlerësimit të cilësisë së institucionit aplikues apo të programeve të tij të studimit, duke u bazuar në standardet dhe udhëzuesit për akreditim, në të cilin ofrohet edhe rekomandimi final për riakreditim apo mosakreditim. Pas vlerësimit të këtij raporti, KShC vendosë për akreditim/riakreditim apo ta refuzojë.

AKA-së i lejohet trajtimi i këtyre aplikacioneve në periudhë prej një viti, prej datës së pranimit të kërkesës për akreditim ndërkaq kërkohet që këto aplikacione, të dorëzohen në Agjenci më së largu me 31 tetor.

Akreditimi institucional fillestar është për tri vite dhe riakreditimi jo më shumë se pesë vite, përveç rasteve kur ekipi i vlerësuesve të jashtëm rekomandon një kohëzgjatje tjetër e cila merr pajtimin e bordit të KShC-së. Ndërkohë, kohëzgjatja e riakreditimit të programit studimor, është tri deri në pesë vite, pos rasteve me rekomandim ndryshe.

AKA mund ta tërheq vendimin e saj për akreditim në çfarëdo kohe, nëse kushtet e dhëna me rastin e akreditimit janë shkelur, nëse aplikuesi ka dorëzuar informata dhe dokumente të rreme të cilat kanë ndikuar në dhënien e akreditimit, si dhe nëse raporti i monitorimit nga vlerësuesit ndërkombëtarë konstaton se rekomandimet e vlerësuesve të jashtëm nuk janë zbatuar dhe gjendja faktike në institucion është dëmtuar rëndë në aspektin e cilësisë.

Komisioni i Ankesave shqyrton ankesat e parashtruara nga IAL-ët kundër vendimeve të KShC-së dhe nxjerr vendim brenda 30 ditësh nga data e dorëzimit të tyre.

DEKLARATË E MOHIMIT TË PËRGJEGJËSISË:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim në kuadër të projektit "Cilësi, Llogaridhënie, Integritet dhe Transparencë në Arsimin e Lartë – QAINT". Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

With funding from

Austrian Development Cooperation

Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju
Ministry of Education, Science and Technology

KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center

ORCA organizata për mbjen e cilësisë në arsim

ZSI Centre for Social Innovation